

# “Të sfidojmë hapësirën e shoqërisë civile të Ballkanit Perëndimor, e cila po tkurret dita-ditës”



Së bashku...

Prej muajit Korrik 2022, 5 organizata të shoqërisë civile, aktive në shtetet fqinje të Ballkanit Perëndimor si Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e Veriut dhe Bosnjë Hercegovinë, bashkëpunojnë për të sfiduar hapësirat e shoqërisë civile, të cilat po tkurren nga një sërë faktorësh si: situata jo e qëndrueshme politike, informaliteti në tregun e punës, emigrimi i të rinjve dhe profesionistëve nga vendi i origjinës, masat represive dhe burokratike të vendosura nga aktorët qeveritarë dhe institucionalë etj.

## Objektivat

- Kontribuojmë në forcimin e shtetit të së drejtës dhe monitorojmë nivelin e garantimit dhe mbrojtjes të të drejtave të grupeve të marginalizuara e pakicave kombëtare.
- Promovojmë bashkëpunimin ndërmjet aktoreve të shoqërisë civile, për të luftuar efektivisht intolerancën, diskriminimin, ekstremizmin e dhunshëm, si dhe përdorimin e gjuhës së urrejtjes e përhapjen e lajmeve të rreme.
- Mbështhesim mbrojtësitë e të drejtave të njeriut (HRD) për të advokuar dhe reaguar në kushtet e tkurrjes së hapësirës së shoqërisë civile.

## Cilat janë synimet tona?

Të kontribuojmë në forcimin e grupit të organizatave të shoqërisë civile në Ballkanin Perëndimor nepërmjet iniciativave të përbashkëta dhe takimeve të rregullta.

Të ndikojmë në politikëbërje në zbatimin të rekomandimeve të OSBE mbi mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të aktivistëve të shoqërisë civile.



Të vlerësohet situata dhe ndikimi që ka sektori i shoqërisë civile në bashkëpunimin e qëndrueshëm rajonal.

Të adresojmë shkeljet e konstatuara ndaj të drejtave dhe lirive themelore të aktivistëve të shoqërisë civile.

# Aktivitete gjatë vitit 2022

Organizata partnerë "Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Bosnie Hercegovinë" ka kontribuar në:

- Mbrojtjen efektive për garantimin e të drejtave të aktivistëve dhe trajtimin me dinjitet të tyre pas arrestimit gjatë zhvillimit të një proteste.
- Sfidimin e tkurjes që po pëson hapësira e shoqërise civile nëpërmjet një takimime përfaqësues të OSCH-ve duke vënë theksin në përgjegjësinë e institucioneve kompetente për zbatimin e sanksioneve ndaj zyrtarëve/individëve të cilët përhapin gjuhën e urrejtjes dhe kercenojnë aktivistët mbi bazën e paragjykimeve.
- Ndërgjegjësimi për gjuhën e urrejtjes së përdorur ndaj përfaqësuesve të shoqërise civile nëpërmjet zhvillimit të një fushatës kombëtare online.



Organizata partnerë "Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Maqedoninë e Veriut" ka kontribuar në:

- Mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBTIQ+ nëpërmjet realizmit të takimeve me përfaqësues të këtij komunitetit mbi garantimin efektiv të të drejtave të tyre.
- Sfidimin e hapësirës së shoqërise civile, e cila po tkurret, nëpërmjet një takimi me përfaqësues të OSCH-ve dhe përcjelljen e shkresave zyrtare institucioneve përkatëse për mungesën e mbështetjes sistematike dhe tendencën e përfshirjes së OJF-ve në procese vetëm në mënyrë deklarativer.
- Promovimin e produkteve dhe aktivitetave të ndërmarrja, nëpërmjet fushatës kombëtare online për mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBTIQ+, ndërgjegjësimin për gjuhën e urrejtjes dhe tkurjen e hapësirës së shoqërise civile.



Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka kontribuar në:

- Verifikimin e nivelit të respektimit tëtë drejtave procedurale ligjore të një gazetari i cili pretendohet se kishte përhapur lajmë të pavërteta ndaj një ish përfaqësuesje të sistemit të drejtësisë.
- Sfidimin e hapësirës së shoqërise civile e cila po tkurret nëpërmjet një takimi të përbashkët me përfaqësues të shoqerisë civile, ku u dakordësua mbi mundësinë e krijimit të një grupimi informal me synim realizimin e bashkëbisedimeve periodike e sistematike mbi trajtimin e sfidave e vështirësive, si dhe reagimin e përbashkët mbi situata e kauza që prekin sektorin.

Organizata partnerë "Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut ne Serbi" ka advokuar në:

- Verifikimin e garantimit të të drejtave dhe trajtimin me dinjitet të një protestuesi i cili për shkak të veprimeve të tij gjatë protestës "ECO" u dënuar me 10 muaj burgim.
- Sfidimin e gjuhës së urrejtjes që përdoret ndaj përfaqësuesve të shoqërise civile dhe adresimin e mesazheve të përbashkëta ndaj autoritatieve publike për vendosjen para përgjegjësisë ndaj cilitdo që e përap atë.
- Promovimin e lirisë së medias, lirisë së tubimit dhe ndërgjegjësimin për gjuhën e urrejtjes, nëpërmjet fushatës kombëtare online.



Organizata partnerë "Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës" në Kosovë ka advokuar në:

- Verifikimin e situatës së respektimit të të drejtave të protestuesve të arrestuar dhe trajtimin dinjitoz në protestën e datës 01 dhjetor 2022 për dhunën e ushtruar në familje, nëpërmjet misioneve monitoruese në stacionet e policisë.
- Fuzizimin e hapësirës së shoqërise civile nëpërmjet takimeve me përfaqësues të OSCH-ve për "Lénien pas të sé kaluarës" dhe identifikimin e sfidave aktuale të hasura dhe rritjen e bashkëpunimit.



"Ky material është prodhuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit në kuadër të nismës "Drejt një bashkëpunimi më të madh ndërkulturor, ndërfetar dhe ndërfetar në Ballkanin Perëndimor", mbështetur nga Austausch, një organizatë joftimprurëse, Platforma e Solidaritetit Qytetar dhe me mbështetjen financiare të Ministrisë së Jashtme Federale të Republikës Federale të Germanisë."